

EVALDA PACI

DËSHMI SHKRIMORE E HISTORIKE TË NJË PERIUDHE TË RËNDËSISHME PËR HISTORINË E LETËRSISË SË SHKRUAR SHQIPE (KONCILI I PARË I ARBËNIT, 1703)

Historia e dokumentimit shkrimor të gjuhës shqipe shënohet hershëm nga dëshmi fragmentare që jo domosdoshmërisht i përkasin vetëm traditës studimore gjuhësore. Dëshmi të tilla janë më solide rreth vitit 1555, nëse flasim për vepra më të plota në pikëpamje të kompaktësisë tekstore dhe unitetit përmbajtësor, për t'u përforcuar me prova të lëndueshme në pikëpamje të shqipërimit e përshtatjes së manualeve kateketikë të kohës në vitet 1618-1621 e më tej me vepra të natyrës leksikografike (1635), për të kulmuar me një realizim koherent në këndvështrim të trajtesave filozofike e ezegjetike, siç është vepra *Cuneus prophetarum* e Pjetër Bogdanit, botuar së pari në Padova, në vitin 1685.

U kushtohen çështjeve të trajtimit të fillimit të shkrimit shqip e historikut përkatës studime kryesisht të natyrës historiografike, ndaj të cilave elementet gjuhësore e detajet e karakterit filologjik japin një ndihmesë të padiskutueshme, si udhërrëfyes të një metode kërkimore që hedh dritë mbi brendinë e dokumenteve që datojnë para vitit 1555 e gjithashtu si mbështetëse të konsideratave që mëtojnë ta dëshmojnë më të hershëm në pikëpamje kronologjike inicimin e një tradite shkrimore që njëkohësisht provon se pikë së pari në viset tona synohej të lëvrohej kultura e mendimit dhe ajo e shkrimit, pavarësisht gjuhës së përdorur, e cila ndër të tjera dhe me prevalencë të vetëkuptueshme duhet të ishte latinishtja librore. Një çështjeje të tillë historiani dhe filologu i ndjerë Injac Zamputi i kushton një prej studimeve më të rëndësishme të tij në këtë fushë gjurmimesh, duke nënvizuar rëndësinë që paraqesin dhe detajet më të vogla tekstore në dritë të interpretimit përmbajtësor të dëshmimeve fragmentare që bëjnë fjalë pikërisht për këtë argument, lëvrimin e shkrimit ndër shqiptarë dhe traditën e kulturës së librit ndër ta.

Një traditë e tillë vijon të përfaqësohet në ditët tona me një numër dokumentimesh shkrimore që variojnë nga dëshmi të shkëputura e që kërkohen pa dyshim gjurmime të mëtejme sa i takon datimit dhe saktësimin

kronologjik përkatës, në vepra më të plota që janë një pasqyrë e përpjekjeve aspak spontane për të lëvruar shkrimin shqip në sprova që lidhen me praktikën e liturgjisë, në veçanti asaj të përditshme dhe me qëndrueshmërinë e besimit të krishterë në viset tona.

Përveç *Mesharit* të Gjon Buzukut, autori i të cilit na jep vitin 1555 si vit të përfundimit të *fëdigës* së tij me lavrimin e të shkruomit të shenjtë në gjuhën tonë, sprovave të Pjetër Budit që në një hapësirë të ngushtë kohore realizoi shqipërimin e doracakëve që mbështeteshin fuqishëm nga Kisha e Romës mbas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit, Dicionarit latinisht-shqip të Frang Bardhit (Romæ, 1635), botimi i të cilit paraprin atë të veprës së Pjetër Bogdanit (Patavii, 1685), një vepër me vlerë të shumëfishtë përfaqëson botimi i Akteve të Koncilit të parë të Arbënit (Provinciale sive Nationale Concilium Albanum), punimet e të cilit zhvillohen gjatë vitit 1703, pikërisht gjatë pontifikatit të Papës Klementi XI, emri i të cilit është i lidhur pazgjidhshmërisht me këtë ngjarje të shënuar për historinë e Kishës së Romës e për provincën përkatëse shqiptare. Fillimet e këtij pontifikati datojnë në nëntor të vitit 1700, pothuaj tre vjet para fillimit të ndërmarrjes aspak të lehtë për të mbajtur e mbështetur një koncil solemn kishtar në viset e Arbënit.

Vëmendja e Papës Klementi XI ndaj zhvillimeve konkrete të kishës shqiptare dhe vullneti për konsolidimin e saj nënvizohet së tepërmi dhe në materialet tekstore që shoqërojnë shtjellimin e akteve përkatëse të këtij koncili. Letrat dedikatore me të cilat hapet korpusi i këtyre akteve i drejtohen në mënyrë eksplicite e me atribute celebrative personalitetit të këtij prelati, dhe njëkohësisht hedhin dritë mbi një realitet të dhimbshëm që sundonte në viset tona si rrjedhojë e një pushtimi të egër që zgjaste tashmë prej kohësh, me pasoja jo të vogla dhe në jetën shpirtërore e ekonomike të popullsisë vendase. Përfaqësojnë të tilla letra jo vetëm një motiv përkimi me tekste të ngjashme të veprave të tjera të së njëjtës traditë shkrimore në shqipe, por dhe një përmbajtje të qartë ndaj modeleve të kohës, në të cilën botime të kësaj natyre parapriheshin me çdo kusht nga kushtime të tilla, të zgjeruara dhe në pikëpamje të përmbajtjes dhe të celebrimit të personit që përfaqësonte hierarkinë e kohës apo motivonte daljen në dritë të shtypit të veprës së shkruar.

Janë pikërisht këto dokumente introductive të botimit të Akteve që dëshmojnë qartë interesimin e Papës Klementi XI ndaj mbarëvajtjes dhe ripërtëritjes së jetës kishtarë e praktikës liturgjike në vendin tonë, të lënduara dhe të rrëguara në mënyrë të ndjeshme nga ç'ndodhte në mënyrë të vazhdueshme në viset ku praktikoheshin besimi i krishterë dhe ku më tepër

Dëshmi shkrimore e historike të një periudhe të rëndësishme...

kishte trysni për ta tronditur qëndrueshmërinë e këtij besimi. Mjafton të lexojmë relatimet e vijueshme të vizitës baritore që Emzot Bizzi, kryepeshkvi i Tivarit zhvillon në viset shqiptare gjatë vjetit 1610, të dokumentuara në mënyrë skrupuloze dhe me saktësimet e duhura nga ana e Atë Pashko Bardhit O.F.M. në të përkohshmen *Zâni i Shna Ndout* (1917 e më tej) për të kuptuar vështirësitë e çdo natyre, të pasqyruara ndër të tjera dhe në pengesa konkrete për të celebruar liturgjinë dhe për të ndjekur besimtarët në fshatra e zona të caktuara. Ndjekja e një gjeografie të mirëfilltë në pikëpamje dioqezash dhe ndarjesh administrative të kohës shoqërohet në këto përshkrime të Atë Pashko Bardhit dhe me informimin mbi peripecitë që duhej të kalonin si prelatët e kishës, ashtu dhe besimtarët dhe rregulltarët e thjeshtë në pikëpamje të respektimit (observimit) dhe praktikimit të riteve kishtarë.

Konteksti historik i përgatitjes dhe i zhvillimit të Koncilit nuk është fort i ndryshëm nga ai që shoqëroi përvijimin e veprave më të rëndësishme të letërsisë së vjetër të shkruar shqipe përfshirë kontributet e sipërcituara (shqipërime e përshtatje) të Pjetër Budit (1618-1621) e *Cuneus prophetarum* të Pjetër Bogdanit (1685). Kohën e mbledhjes së këtij koncili e ndajnë pak vite nga realizimi përfundimtar dhe dalja në dritë të shtypit e veprës së Bogdanit, i cili parashtron qartë e hapur në parathënien e veprës së tij rreziqet që sjell padija e nënshtrimi i detyruar i një populli.

Konsiderimi i një sërë elementesh tekstore nga të dyja këto vepra, ajo e Bogdanit dhe çka parashtrohet e nënvizohet në motivimin e Akteve të Koncilit të Arbënit (1706) pa dyshim të bën të mendosh për një linjë të përbashkët që i qas njëra me tjetrën, por dhe me një vijimësi të natyrshme përpilimesh që dhe pse me natyrë pothuaj krejt të ndryshme tekstologjike, për afrohen natyrshëm nga rrethanat historike dhe nga një realitet mjaft i dhimbshëm në dheun e Arbënit. Sigurisht, një qasje më e hollësishme mes elementesh të ngjashme që shoqërojnë introduktimin e të dy veprave në fjalë do të provonin më së miri gjykimet e sipërpërmendura, gjithashtu do të rikonfirmonin prirjen e qartë të autorëve përkatës për të ndjekur një linjë kanonike në pikëpamje të përpilimit të teksteve të këtyre veprave.

Dallimet mes veprave të sipërpërmendura janë pikë së pari dhe të natyrës gjuhësore, duke qenë pikënisja në pikëpamje autorësie gjithashtu e ndryshme, por motivimi i inicimit të gjithsecilës mbetet një faktor më shumë dhe për t'i konsideruar e renditur këto realizime dhe si pjesë e një tradite shkrimore që hedh dritë natyrshëm në një periudhë të rëndësishme historike për kombin e vendin tonë.

Nga ana tjetër, vetë çështjet që shtrohen në këtë koncil dhe personalitetet që përfshihen në të, mbeten elemente të dhënash me vlerë pikërisht për këtë periudhë historike dhe gjithë veshjen sociale e politike që e shoqëron atë. Çështjet e konsiderimit të respektimit të sakramendeve, praktikimit korrekt të tyre, në veçanti sakramendi i martesës dhe ligjshmëria e tij, shkollave të Kurbinit e të Lezhës si promotore të një edukimi kompleks klerikal e human, laramanisë dhe rrezikut që kalonte besimi i krishterë në vendin tonë, ushtrimin të besimit dhe mësimit të fesë me anë mjetesh didaktike mbeten më të rëndësishmet në përmbajtjen e problematikës së vetë Koncilit dhe në Aktet përkatëse që do të shohin dritën e shtypit pothuaj tre vjet pas mbajtjes së tij. Hollësitë që shtjellohen në lidhje me këto argumente pasqyrojnë në të njëjtën kohë sa e vështirë mbetej ruajtja e besimit dhe dinjiteti i individit, dhe këto fakte do të rikonfirmohen dhe ndërsa gjurmohet prej studiuesve në pikëpamje dokumentare e gjithë veprimtaria prej meshtari e prelati e Gjon Nikollë Kazazit, jeta e të cilit përshkohet në mënyrë të ndjeshme nga sprova të vështira përballë situatash të ngjashme, fare pak vite mbas përfundimit të punimeve të këtij Koncili.

Gjendja e mjerueshme që zotëronte në mbarë vendin dhe vështirësitë e klerit katolik për të përballuar situata gjithfarëshe mbeten ndër të tjera premisa themelore që çuan dhe në mbledhjen e një koncili të tillë aq të rëndësishëm për kohën dhe për historinë e vendit tonë. Një motivim i tillë do të shprehet qartë nga ana e të ngarkuarit nga Papa Klementi XI, Imzot Vincens Zmaievick, personalitet mjaft i ndërmendur në historinë e kishës shqiptare të asaj periudhe, përmendur me mjaft hollësi e detaje informuese dhe nga Arqipeshkvi tjetër i Tivarit e i Shkodrës, Carolus Pooten në shënimet e tij gjatë vitit 1864, që, për nga natyra, na kujtojnë një Compendium sintetizues të veprës madhore disavëllimëshe Illyricum Sacrum. U jemi referuar detajeve të tilla të renditura në pikëpamje kronologjike për të vënë në dukje pikërisht rolin e pamohueshëm të Papa Klementit XI në promovimin e Imzot Zmaievick, rrugëtimi meshtarak i të cilit shënohet ndjeshëm në hapat themelorë të tij nga vëmendja e këtij të fundit. Cilësohet Vincens Zmaievich si qytetar i Perastit prej derës fort të shquar të Zmaievicheve, nxanës i Kolegjit të Propagandës (S. Congregationis de Propaganda Fide alumnus), burrë i shquar, i fuqishëm në vepra e në ligjërimi (potens in opere et sermone):

Civis Perastinus fuit ex illustri Zmajevichia domo, S.Congregationis de Propaganda Fide alumnus, magnus sane vir, potens in opere et sermone. Andreas patru, quem sibi ad imitandum

proposuit, vestigiis insistens insigni doctrina et prudentia, eximia in Deum ac superos Religione, ac rerum gerendarum industria floruit.

Senatus Venetus Abbatem templi Georgiani Perastini eum nominavit, et paullo post Clemens XI neminem Vincentio digniorem censens, cui Archiepiscopatum Antibarensem conferret, an.1701. 18 aprilis hanc Metropolim eidem decreverit. Marinus Drago Episcopus Catharensis in templo Georgiano Perasti Consecratione Episcopali illum inauguravit.

Vincentio Archiepiscopi Antibarensi et Ecclesiae Buduensis Administratori munus quoque Visitoris Apostolici Albaniae a Clemente XI impositum est. Statim vero ac Provinciae sibi concredita possessionem adivit, initium visitationis Apostolicae ab sua Dioecesi fecit; deinde omnes Albaniae et Serbliae Ecclesias ingenti labore, nec minori illarum gentium et rei Christianae utilitate lustravit. Post peractam Albaniae ac Serbliae peragratiorem Concilium nationale convocavit in pagum Dioecesis Alexiensis, cui nomen Merchigne, atque Aedem S.Ioannis Baptistae convenerunt tres Archiepiscopi, quatuor Episcopi, tres viri Religiosi e familia Franciscana Praefecti Apostolici, unus e Dominicana familia, qui suis nominibus subscriptis omnia Decreta approbarunt a Vincentio facta et lata, religionis et sapientiae plena, partim jubendo partim vetando, quae temporum illorum ac locorum necessitas requirebat. **Hanc Synodum sub initium anni 1703 celebratam, quae a regione Albana sive Albanensis dicta est, Vincentius ex mandato S.Congregationis typis consignandam curavit, et Clementi XI Pontifici Maximo inscripsit.**

Annos duodecim Vincentius provinciam Antibarensem administravit. **Clemens XI ut labores et aerumnas quibus rei Christianae in Albania et Serblia tuendae et augendae causa perfunctus erat, aliqua remuneratione compensaret, anno 1713, 22 Maji ex Antibarensi Provincia, plena curarum et periculorum ad Iadertinam tamquam ad portum tutissimum illum transtulit, ubi rebus gestis eruditisque operibus editis clarissimus, et 75 annos natus die 11 Septembr.an.1745 ad beatam immortalitatem migravit.**

Thuhet qartë në shënimet e Karl Poten që Klementi XI nuk gjet njeri më të përshtatshëm e më të denjë se Zmaievickun për t'i besuar Argjipeshkvinë e Tivarit, rol ky që dekretohet prej tij në prill të vitit 1701, një vit pas inicimit të pontifikatit të tij dhe dy vjet para thirrjes së Kuvendit të Arbënit. Sërish prej Papa Klementit XI Zmaievick emërohet administrator i kishës së Budvës dhe Vizitator Apostolik i provincës së Arbënit. Për rolin e vizitatorit vetë Zmaievick na informon në pjesët hyrëse

të Akteve të Koncilit, por dihet që dekretet që ai paraqet para pjesëmarrësve në këtë sinod aprovoen duke u cilësuar të karakterizuara nga forca e besimit dhe nga dija. Qe gjithnjë Zmaievick që, me mandat të Kongregacionit të Propagandës, i kuron aktet e sipërpërmendura, duke i përgatitur për shtyp dhe duke ia dedikuar që në hyrje pikërisht Papa Klementit XI. Çka paraqitet i një rëndësie të dorës së parë është pikërisht fakti që vetë Kongregacioni udhëzon botimin e këtyre akteve në dy gjuhë, në latinisht dhe në shqip dhe në këtë pikëpamje një vendim i tillë siguroi ndër të tjera një tjetër dëshmi monumentare shkrimore për studimet tona ndërdisiplinore por dhe specifike në fushë të albanologjisë. Gjithnjë duke iu referuar shënimeve të vjeshme të Karl Poten, rezultojnë dhe emra të tjerë ipeshkvinjsh të emëruar në kohë të Papës Klementi XI dhe që figurojnë se kanë nënshkruar në aktet përfundimtare të këtij koncili (përkatesisht Marin Gjini prej Shkodre). Pikërisht në materialet e Pootenit prania e tij në këtë sinod nënvizohet dhe dokumentohet më se një herë bashkë me faktin që është promovuar në periudhën e pontifikatit të Klementit XI: **Concilio Albano interfuit, ejusque Decretis subscripsit hac formula: Ego Marinus Gini electus Episcopus Pullatensis assentiens subscribo.**

Gjurmohen në Aktet e këtij koncili variante të teksteve themelore të liturgjisë së përditshme, përfshirë *Besojmën* dhe përdorime të tjera që jo përherë përkojnë në pikëpamje elementesh me variantet që kemi ndeshur në autorët paraardhës në pikëpamje kronologjike. Përbën ky variant një pasuri të shtuar për këdo që ndërmer studimin përmbajtësor të modeleve që ofrohen nga një autor në tjetrin, duke pasur parasysh ndër të tjera tekstin gjegjës që gjen dokumentim së pari në librin e Gjon Buzukut. Një moment i rëndësishëm mbetet ndërmendja e rëndësisë që përbën njohja e katekizmit për të krishterët dhe vëmendja e disponimit të tyre nga ana e Kongregacionit të Propagandës, në lidhje me të cilën përmendet shprehimisht Doktrina e Bellarminos dhe e varianteve të saj¹. Një fakt i tillë do të përbente dhe më tepër rëndësi nëse do të shoqërohej me ndonjë të dhënë më shumë në lidhje me variantet konkrete për të cilat mendonte Kongregacioni i Propagandës, duke qenë se në studimet tona zakonisht supozohet për mundshmërinë e njohjes nga ana e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe të veprave të njëri-tjetrit.

Janë pikërisht realizime të kësaj natyre tekstologjike që dhe pse nuk kanë natyrën përmbajtësore e plotësisht të përcaktuar në pikëpamje

¹ Shih për këtë *Kuvendi i Arbënit*, Romë, 1706, f. 27.

Dëshmi shkrimore e historike të një periudhe të rëndësishme...

tipologjike të veprave të tjera që u cituan më sipër, mbeten burime të pashtershme të dhënash jo vetëm për disiplina specifike studimore që u përkasin gjurmimeve albanologjike (histori e gjuhës, dialektologji historike, leksikologji historike, histori e shkrimit), por që njëkohësisht janë burimet që furnizojnë natyrshëm informacione mbi historinë e besimit në vendin tonë dhe përfshirjen e këtij të fundit në një proces të vështirë integrimi dhe mbijetese.

Përmbajtja e akteve të këtij koncili mbështet e paraprin natyrshëm atë të koncileve pasardhëse të Arbënit, të mbajtura përkatësisht më 1871 dhe 1895, por që përkrijnë në momente të caktuara në pikëpamje të brendisë me të parin kuvend dhe për të cilat dhe në ditët e sotme disponojmë rishtypjen anastatike, por jo dhe shqipërimin dhe fatmirësisht botimin përkatës kritik si në rastin e Koncilit të parë të vitit 1703. Do të ecin natyrshëm dhe këto dy koncile në gjurmët e Kuvendit të Parë, duke qenë ky i fundit mjaft i ndërmendur dhe në aktet përkatëse të secilit.

Jehona e Kuvendit të Arbnit ndihet qartë që në hapjen e punimeve të Concilium Albanum secundum (1871), siç dhe do të pohohet në fletëthirrjen (*Litterae indictionis*) e shkruar në këtë vit prej Arqipeshkvit të Tivarit e të Shkodrës (Karl Poten), e që u prin Akteve përkatëse të këtij koncili, botimi i të cilave daton në vitin 1876. Cilësohet mjaft pozitivisht vetë mbledhja e Koncilit dhe iniciativat e ndërmarra në të, pavarësisht pamundësisë për realizimin e mjaft dekreteve përkatëse të tij:

Salutaria sane tot tantisque malis remedia sapientissimum Albanum Concilium anno 1703 habitum afferre studuit: at vero plurima ex decretis Spiritus Sancti lumine in eodem conditis vel nunquam fuerunt sugillanda desidia executioni mandata, vel etiam culpanda desuetudine oblivioni misere tradita².

Dhe në hyrjen me të cilën ky arqipeshkëv u drejtohet pjesëmarrësve në këtë Koncil në veshjen e delegatit apostolik evokimi i ngjarjes së Koncilit të vitit 1703 është më se i qartë, bashkë me nënvizimin e kontekstit konkret që bëri të mundur mbledhjen dhe mbajtjen e tij. Sipas Potenit, ky koncil fort i shquar u celebrua prej paraardhësit famëmirë Vincens Zmaievick, Arqipeshkëv i Tivarit e vizitator apostolik i dheut të

² *Litterae indictionis Concilii Provincialis Sive Nationalis*, marrë nga *Concilium Albanum secundum provinciale sive nationale, habitum Anno MDCCCLXXI Pio IX. Pontifice Maximo*, Romae, Typis S.C. De Propaganda Fide, MDCCCLXXVI, f. 3-4.

Arbënit, me qëllim që t'i kthehej integriteti kishës sonë dhe të shëroheshin plagët e hapura të provincave³.

Në tekstet e Akteve të Koncilit bien në sy përdorime që, në pasazhe të ndryshme, do të ndeshen dhe me modifikime të lehta të formës. Bien në sy gjithashtu raste përdorimi orientalizmesh jo të rralla që dëshmojnë ndikime të qarta të shkruarit të atyre radhëve nga kultura mendore e kohës dhe prirje të përbashkëta me botime të mëvona, ndër të cilat do të citonim doktrinën e kërshenë në variant dygjuhësh të Atë Guagliatës S.I. (Romë, 1845).

Janë pikërisht këto tekste në të cilat do të ndeshim të përdorur më se një herë sintagmën *Zonjë e bekueme*, për Amën e Tinëzot, një figurë së cilës i referohen qartazi dhe pasardhësit në dy koncilet e mëtejme kishtarë. Do të ndeshet sërish ky emërtim në Doktrinën e Kazazit, botuar nën vëmendjen e Kongregacionit të Propagandës në vitin 1743, në trajtën e një përmbledhjeje të thukët doktrinare, por mjaft të qartë nga konceptet themelore të besimit të krishterë dhe shtjellimit në parim të tyre.

Ka mjaft për të thënë për brendinë e teksteve të këtyre akteve dhe për vështrimin diakronik që mundëson ndër të tjera distanca kohore që na ndan prej kësaj ngjarjeje dhe perspektiva gjithnjë mbizotëruese e vëzhgimeve gjuhësore e filologjike.

Për traditën e studimeve në fushë të historisë së shkrimit, tekstet e Akteve të Koncilit të Arbënit qëndrojnë në një kapërcyell të rëndësishëm, që lidhet drejtpërdrejt me periodizimin e letërsisë së shkruar shqipe (më saktë, letërsisë së vjetër), për historianët dhe hulumtuesit e historisë së Kishës në këto tekste dhe në vetë ngjarjen e mbledhjes së tij gjurmohet prirja për të ruajtur e forcuar besimin dhe fenë në viset tona.

³ Caroli Pooten Archiepiscopi Antibarenensis et Scodrensis delegati Apostolici ad Synodum Allocutio, marrë nga *Concilium Albanum secundum provinciale sive nationale, habitum Anno MDCCCLXXI Pio IX. Pontifice Maximo*, Romae, Typis S.C. De Propaganda Fide, MDCCCLXXVI, f. 6: Anno Domini 1703, Dominica secunda post Epiphaniam perillustre Concilium Albanum a clarissimo praedecessore nostro Vincentio Zmaievick Antibarenensi Archiepiscopo et Albaniae visitatore apostolico celebratum fuit, ut labentem eius aevo Ecclesiae nostrae statum in integrum restitueret, apertis Provinciarum vulneribus praebendo medelam.